

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIN TË AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2024



12 Shkurt 2025

Pranë ambienteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua workshop-i “Analiza Vjetore e Veprimtarisë për Vitin 2024” për Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Ky aktivitet pati për qëllim vlerësimin e punës së bërë gjatë vitit 2024 dhe planifikimin e veprimtarisë audituese për vitin 2025.

Workshop-i nisi me fjalën hyrëse e Kryetarit të KLSH-së, Z. Arben Shehu. Në fjalën e tij, Z. Shehu theksoi rëndësinë e auditimeve që kryhen nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe rëndësinë e punës së çdo audituesi në veprimtarinë e KLSH, por dhe më tej.

Pas fjalës së Kryetarit të KLSH-së, Znj. Joana Troqe, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit falenderoi departamentin për bashkëpunimin dhe shprehu mbështetjen e saj, për të vijuar kështu dhe në 2025. Paraqiti gjithashtu një prezantim mbi aktivitetin e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, ku u përmendën auditimet e kryera gjatë 2024, opinionet e dhëna dhe ato të planifikuara për vitin 2025, si dhe u bë një përmbledhje mbi strukturën e këtij departamenti në numër audituesish, arsim, moshë mesatare, etj.



Pjesa tjetër e workshopit vijoi me 4 prezantime të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2024 konkretisht si më poshtë:

- Z. Albert Hoxhalli, prezantim mbi auditimin e kryer në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Znj. Krisela Ngjela, prezantim mbi auditimin e kryer në Agjencinë e Menaxhimit të Kredive dhe Garancive të Pakthyerë;
- Z. Altin Dinaj, prezantim mbi auditimet e kryera në fushën doganore (DPD, Dega e Doganës Gjirokastër dhe Dega e Doganës Tiranë);
- Z. Redon Xhelilaj, prezantim mbi auditimet e kryera në fushën tatimore (DPT, DRT Fier dhe DRT Vlorë).

Pas prezantimeve nga të pranishmit pati diskutime mbi realizimin e objektivave të vitit 2024 dhe mbi planin e veprimtarisë në 2025, ku audituesit patën mundësinë të shprehnin mendimet dhe sugjerimet e tyre për të përmirësuar procesin e auditimit.